

**Nr. 2310/56 K (e-k) Prot.**  
**Tiranë, më datë 19/10/2023**

**Drejtuar:** Komisionit Qendror të Zgjedhjeve  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
z. Ilirjan CELIBASHI

**Për dijeni:** Komisionit të Ankimimeve dhe  
Sanksioneve

**Lënda:** REKOMANDIME – Lidhur me  
projekt vendimin “Për përcaktimin  
e procedurave të këqyrjes  
paszgjedhore të fletëve të votimit  
dhe materialeve zgjedhore, për  
zgjedhjet e organeve të  
vetëqeverisjes vendore”

**I Nderuar z. Komisioner!**  
**Të nderuar Drejtues së Administratës së KQZ-së!**

Në kuadër të gjithë bashkëpunimit me ju lidhur me konsultimin paraprak të projekt-akteve të ndryshme, gjejmë rastin t’ju falënderojmë sërish për dërgimin për mendim të projekt-vendimit “Për përcaktimin e procedurave të këqyrjes paszgjedhore të fletëve të votimit dhe materialeve zgjedhore, për zgjedhjet e organeve të vetëqeverisjes vendore”, dhe ju paraqesim më poshtë disa propozime të KRIIK në lidhje me përmirësimin e tij.

Fillimisht na lejoni të risjellim në vëmendjen tuaj se lidhur me ecurinë e tërë procesit të auditimit paszgjedhor të kryer për herë të parë pas zgjedhjeve parlamentare të vitit 2021, si dhe pas zgjedhjeve të pjesshme të datës 6 mars 2022, KRIIK ka kryer analizën e tij dhe ka publikuar gjetjet nëpërmjet raporteve përkatëse të monitorimit të të dyja proceseve. (Pjesët përkatëse të raporteve mund t’i gjeni për lehtësi konsultimi bashkëlidhur të kësaj shkrese)

Në këto procese, përpos monitorimit të procesit në sallë, KRIIK mori nga KQZ-ja të gjithë procesverbalet e plotësuar nga grupet e verifikuesve, i hodhi të dhënat në një bazë të dhënash elektronike dhe i përpunoi në mënyrë të pavarur ato.

Nga monitorimi i KRIIK, rezultuan të evidentuara një seri problematikash të cilat lidheshin me: - Udhëzimin e miratuar; - sjelljen e nëpunësve të KQZ të cilët u angazhuan në këqyrjen e materialeve zgjedhore; - përfshirjen në shortim të QV-ve të cilat sipas ligjit duhet të ishin përjashtuar; - përjashtimin e QV-ve për të cilat ishte kryer më herët hapja vetëm e kutisë së fletëve të votimit në procesin ankimor, duke imunizuar për këtë arsye edhe kutinë e materialeve zgjedhore; - trajtimin e gjetjeve të cilat rezultuan nga procesi i auditimit, etj.

Ndërkohë që qëllimi i procesit të auditimit paszgjedhor është verifikimi i saktësisë së kryerjes së detyrave prej komisionerëve zgjedhorë me qëllim nxitjen e përgjegjshmërisë së tyre, si dhe eliminimi i kulturës së pandëshkueshmërisë ndaj çdo shkelësi të ligjit, pjesë

Address:

Rr. "Ymer Kurti",  
Nd.4, H.2, Ap.3,  
Nj.Adm.5,  
Tirana

Mailing address:

P.O.Box. 2396  
Tirana, 1001,  
Albania

e administratës së zgjedhjeve, KRIIK ka konstatuar se problematikat e vërejtura e bënë procesin e auditimit paszgjedhor në rezultante jo eficient.

Sjellim në vëmendje këtu edhe konstatimin e KAS i cili, në vendimmarrjen e tij lidhur me kërkesat e Komisionerit për këtë çështje, është shprehur se "...KAS vlerëson se nga ana e Komisionerit nuk është zhvilluar një procedurë e mirëfilltë hetimore administrative sidomos në drejtim të vlerësimit të gjithanshëm dhe të harmonizuar të provave dhe fakteve me qëllim jo vetëm verifikimin e rregullsisë dhe saktësisë së veprimtarisë së administratës zgjedhore përgjatë administrimit të procesit, vlerësimit dhe numërimit të votave, por kryesisht të ngarkimit të tyre me përgjegjësi ligjore në lidhje me funksionin e ngarkuar në procesin zgjedhor. Në këtë kontekst, procedura hetimore e zhvilluar nga KSHZ nuk është e plotë dhe nuk kënaq në mënyrë shteruese kërkesat e ligjit (...)"

Thënë sa më sipër, KQZ do të duhet të ndërmarrë një seri hapash për përmirësimin e procesit duke e sjellë atë në përmbushje të çdo kriteri ligjor dhe të qëllimit të kërkuar nga ligjvënësi.

**KRIIK ju paraqet dhe gjykon me rëndësi marrjen në shqyrtim të konsideratave të mëposhtme:**

### **1. Auditimi i 10% të Qendrave të Votimit (pika 22 e projektvendimit)**

Nisur nga standardi i vendosur në vitin 2021, nga problematikat e evidentuara gjatë procesit të ankimimeve lidhur me administrimin e procesit nga komisionet e niveleve të dyta dhe të treta, pretendimet publike të subjekteve zgjedhore për sjelljen e komisionerëve, emërimi në momentet e fundit, trajnimi i cunguar apo mungesa e trajnimit, si dhe nga gjetjet e konstatimet e vëzhguesve të pavarur, përfshirë KRIIK, të cilët kanë konstatuar problematika serioze mbi njohuritë administrative të komisionerëve, pavarësisht se Kodi Zgjedhor vendos si limit auditimin e jo më shumë se 10% të QV-ve, në gjykimin e KRIIK numri i QV-ve të audituara duhet të vazhdojë të jetë në kufirin maksimal ligjor prej 10%, pavarësisht kohës fizike që mund të marrë ky proces.

Vazhdimi i auditimit për kufirin maksimal prej 10% të QV-ve konsiderohet si mjaft me rëndësi dhe shumë sinjifikativ lidhur me konsistencën për të siguruar përmbushjen e qëllimit të ligjit dhe institucionit për të rritur përgjegjshmërinë e administratës zgjedhore e ndëshkuar këdo që abuzon me vullnetin e sovranit.

### **2. Përfshirja në shortim e të gjitha QV-ve, përveç atyre tek të cilat janë hapur të treja kutitë (pika nr. 5 dhe nr. 8 e projektvendimit)**

Kodi Zgjedhor në Nenin 167/2 pika 5 përcakton se "...Nuk lejohet kryerja e këqyrjes së fletëve të votimit ose të materialit zgjedhor që është këqyrur më parë kryesisht ose me kërkesë të palëve të tjera të interesuara."

Në gjykimin e KRIIK, gërma e Kodit bën qartas parashikimin se përjashtohet vetëm dhe veçmas ajo kuti e cila është këqyrur më parë.

Duke patur parasysh këtë konsiderim veçmas të fletëve të votimit nga kutia e materialeve zgjedhore, projektvendimi nuk duhet të ketë qasje tërësisht përjashtimore të të tre kutive, nëse vetëm njëra prej tyre i është nënshtruar hapjes më parë.

Address:

Rr. "Ymer Kurti",  
Nd.4, H.2, Ap.3,  
Nj.Adm.5,  
Tirana

Mailing address:

P.O.Box. 2396  
Tirana, 1001,  
Albania

Duke i përjashtuar totalisht këto qendra votimi, këto QV fitojnë status të privilegjuar dhe përjashtohen nga shorti për auditimin e kutisë tjetër të votimit si dhe të kutisë së materialeve zgjedhore.

Ndaj, propozohet që projektvendimi të përjashtojë nga shorti vetëm ato QV për të cilat është bërë më parë këqyrja e të tre kutive (pika 8/a e projektvendimit).

### 3. Përcaktimi paraprak i masës së marzhit të gabimit

Lidhur me rinumërimin e fletëve të votimit, apo auditimin paszgjedhor sasior, niveli i mospërputhjes midis rezultatit të miratuar dhe atij të audituar mund të jetë nga vetëm një votë por edhe një numër shumë më i lartë.

Në auditimin e zgjedhjeve të vitit 2021, vetëm në raportin përfundimtar dhe jo në udhëzimin përkatës, KQZ vendosi që të konsideronte diferencat nga 1 në 20 vota si gabim njerëzor, ndërkohë që numëruesit e QV-ve tek të cilat diferenca në numërimin e votave ishte nga 21 e më shumë vota u referuan në Prokurori si të dyshuar për veprën penale të falsifikimit të materialeve zgjedhore dhe rezultatit të zgjedhjeve.

Në gjykimin e KRIIK shifra e përdorur ishte arbitrare dhe nuk pati asnjë arsyetim pse u konsiderua pikërisht ky numër.

Nga ana tjetër, është e nevojshme të kihet në konsideratë standardi se qoftë edhe një votë të jetë numëruar gabim apo tjetërsuar, përbën devijim të vullnetit të votuesit e për rrjedhim një shkelje ligjore për të cilën numëruesi duhet të mbajë përgjegjësi.

Në opinionin e KRIIK, tërë procedura e numërimit, verifikimit dhe plotësimit të procesverbaleve nuk lë vend për gabim njerëzor.

Nga ana tjetër, vazhdimi i precedentit të vendosur nga KQZ-ja për të vendosur apriori kufi të shkeljes duke e konsideruar si “gabim njerëzor” e çon atë në një diskrecion të tepruar që ligji nuk ia njeh, duke amnistuar shkelje e zhbërë vetë qëllimin e ligjit për këtë proces këqyrje paszgjedhore.

Nëse KQZ-ja gjykon se ka një sërë rrethanash, të cilat duhet të detyrojnë KQZ-në për vendosjen e një kufiri amnistimi me justifikimin si “gabim njerëzor”, atëherë është e nevojshme që kjo e drejtë e KQZ-së të përcaktohet paraprakisht në projekt-vendim.

Në një rast të tillë, projektvendimi duhet të parashikojë që për rrethana të caktuara, të ngarkohet Komisioneri që me urdhër të ngrejë një grup pune për të shqyrtuar gjetjet e vërejtura gjatë procesit të këqyrjes dhe të vendosë duke argumentuar nivelin e marzhit të gabimit.

Në argumentimin e bërë dhe urdhrin e hartuar duhet të parashikohet konsultimi me ekspertë statisticienë, marrja në konsideratë e parimit të proporcionalitetit duke evituar aplikimin në mënyrë të njëjtë të tij për çdo QV pavarësisht numrit të votuesve në të, sasia e kutive të numëruara nga grupi përkatës i numërimit të cilit i atribuohet shkelja, numri i shkeljeve të vërejtura për të njëjtin grup numërimi, etj.

Në gjykimin e KRIIK, konsiderohet me shumë rëndësi që Institucioni i KQZ-së të ruajë e forcojë autoritetin e tij si dhe besimin e publikut ndaj tij, duke ndërtuar një proces institucional, me transparencë maksimale dhe mos lënë vend për ndikime të jashtme politike apo individuale nëpërmjet vendimmarrjeve disreacionale të paargumentuara që çojnë në pandëshkueshmëri, qoftë administrative, qoftë penale.

Address:

Rr. "Ymer Kurti",  
Nd.4, H.2, Ap.3,  
Nj.Adm.5,  
Tirana

Mailing address:

P.O.Box. 2396  
Tirana, 1001,  
Albania

#### **4. Sjellja e grupeve të këqyrjes në raport me plotësimin e procesverbaleve.**

Shumë nga procesverbalet e plotësuara prej verifikuesve në auditimin e vitit 2021, ishin të pa plotësuara plotësisht, pasi në to mungonin të dhëna të ndryshme: si firma, data, numra në vende të ndryshme, shënimi për po ose jo në procesverbalet për verifikimin cilësor të procesit, etj.

Këto të dhëna, janë thelbësisht të rëndësishme në plotësimin e detyrimeve administrative nga administrata e KQZ-së e emëruar për të kryer verifikimin.

Referuar sa më sipër, KRIIK konsideron se procesi i auditimit do të duhet të realizohet me saktësi, seriozitet dhe përgjegjshmërinë më të lartë të mundshme nga ana e grupeve të punës së KQZ-së, për më tepër që këta janë pjesë e administratës së institucionit të KQZ-së.

Gjithashtu, nevojitet që ata të trajnohen paraprakisht për rëndësinë dhe rigorozitetin e ndjekjes së procedurave të procesit të këqyrjes, duke u trajnuar edhe për një kuptim sa më të mirë të përmbajtjes së tyre.

Ndaj si shtesë në pikën 12 të projekt-vendimit rekomandohet të vendoset që grupet e punës trajnohen paraprakisht mbi procedurat e mbikqyrjes.

KRIIK sugjeron që plotësimi në programin kompjuterik të bëhet drejtëpërdrejtë nga vetë grupet e punës, e më pas programi kompjuterik të gjenerojë e printojë dokumentin zyrtar që të firmoset prej tyre për saktësi procedurale.

Futja e një hallke të tretë për hedhjen e rezultateve të grupit të punës, rrit potencialisht mundësitë për pasaktësi dhe gabim njerëzor, duke konsumuar në mënyrë të panevojshme kohë shtesë dhe burime të tjera njerëzore.

#### **5. Problematikat eventuale/çfarë do të konsiderohet gabim njerëzor**

Duke qenë se tashmë KQZ ka dy eksperiencë të procesit të auditimit paszgjedhor, konsiderohet me vend që të grumbullojë e përdorë tërë përvojën e patur në formën e rekomandimeve apo të një manuali praktik për grupet e punës.

Ky manual mund të përdoret në procesin e trajnimit paraprak të grupeve të punës, duke trajtuar tërë tipologjinë e parregullsive apo shkeljeve të vërejtura më parë, shqyrtimin e një liste kriteresh se çfarë do të mund të konsiderohet gabim njerëzor, etj, duke u përpjekur kështu për të evituar sa më shumë të jetë e mundur gjykimet subjektive të anëtarëve të grupit të punës mbi pasaktësitë apo parregullsitë që mund të konstatohen.

#### **6. Përcaktimi i kostove ose i aktit referues**

Në pikën 6 të projekt-vendimit, bazuar në dispozitat e Kodit Zgjedhor, citohet e drejta e subjekteve zgjedhore për të kërkuar këqyrjen e QV-ve të caktuara, duke mbuluar shpenzimet për hapjen e tyre, në përputhje me aktet e KQZ.

Ky është një instrument shumë i rëndësishëm në dispozicion të subjekteve zgjedhore në funksion të ligjzbatimit dhe rritjes së transparencës dhe besimit ndaj procesit zgjedhor.

Address:

Rr. "Ymer Kurti",  
Nd.4, H.2, Ap.3,  
Nj.Adm.5,  
Tirana

Mailing address:

P.O.Box. 2396  
Tirana, 1001,  
Albania

Ato mund të zgjedhin ta shfrytëzojnë këtë instrument në vijim të pretendimeve apo indicieve që mund të kenë patur duke kërkuar këqyrjen e QV-ve me përcaktim. Në këtë aspekt, KRIIK nxit KQZ-në që t'iu dërgojë tërë subjekteve zgjedhore një "Kujtesë" për këtë instrument që ofron ligji ndaj pretendimeve të tyre.

Ndërkohë, është e nevojshme që subjektet zgjedhore të jenë paraprakisht të informuara mbi kostot financiare që implikon shfrytëzimi i këtij instrumenti sikurse përcaktohet në nenin 167/2 pika 5.

Ndaj rekomandohet që projektvendimi i hartuar duhet të përmbajë drejtëpërdrejtë kostot përmbledhtazi, ose të referojë saktësisht aktin përkatës të KQZ-së.

Nga kontrolli i bërë në databazën e akteve të KQZ-së nuk u arrit të gjendet një akt normativ i Komisionit Rregullator për përcaktimin e tarifave të shërbimit administrativ të këqyrjes, sikurse përcakton shprehimisht neni 167/2 pika 6 e Kodit Zgjedhor.

Në rast të mungesës së kësaj vendimmarrjeje do të ishte me vend që KSHZ të shtynte miratimin e këtij projektvendimi, pa u marrë më parë vendimi nga Komisioni Rregullator i cili të bëjë eficient instrumentin në dispozicion të subjekteve zgjedhore për këqyrjen e QV-ve me përcaktim prej tyre.

Një hap i tillë do të konsideroj me shumë vend duke patur veçanërisht në konsideratë, pretendimet nga forcat politike opozitare, si dhe raportet vendase e ndërkombëtare të vëzhgimit të zgjedhjeve.

## **7. Hapja e gjithë QV-ve ku është përdorur Pajisja Elektronike e Votimit dhe Numërimit (PEVN)**

Votimi dhe Numërimi Elektronik u aplikua për herë të parë në tre bashki të vendit. Gjatë ditës së zgjedhjeve dhe procesit të ankimimeve, rezultoi se niveli i mosbesimit nga palët në proces ndaj përdorimit të PEVN-ve ishte i lartë. Gjithashtu edhe problematika e zbatimit të procedurës nga komisionerët në këto QV, për aq sa u diskutua përgjatë ankimimeve në KAS, ishte prezente.

Nga ana tjetër, vetë KQZ, në auditimin paszgjedhor të zgjedhjeve parlamentare 2021 dhe ato lokale të 2022, vendosi standardin e auditimit të të gjitha QV-ve ku ishin përdorur PEVN-të.

Në mënyrë për të adresuar dhe bërë transparencë ndaj të gjitha shqetësimeve e pretendimeve të paraqitura, si dhe për të siguruar ruajtjen e rritjen e mëtejshme të besimit ndaj përdorimit të teknologjisë në zgjedhje, gjykohet se do të ishte e nevojshme dhe me shumë vlerë që auditimi për këto bashki të kryhet në 100% të QV-ve të tyre, dhe jo në 10 % të tyre sikurse është parashikuar në pikën 22 të projekt-vendimit.

## **8. Lidhur me votat e pavlefshme**

Vlerësimi i Grupeve të Numërimit lidhur me votat e pavlefshme, ka qenë një ndër pikat e ngritura si problematikë nga disa subjekte zgjedhore gjatë procesit të ankimimeve.

### Address:

Rr. "Ymer Kurti",  
Nd.4, H.2, Ap.3,  
Nj.Adm.5,  
Tirana

### Mailing address:

P.O.Box. 2396  
Tirana, 1001,  
Albania



Një nga përgjegjësitë e grupeve të punës në këqyrjen e fletëve të votimit dhe materialeve zgjedhore në KQZ është të evidentojnë fletët e votimit të pavlefshme dhe analizojnë natyrën e pavlefshmërisë.

Rekomandojmë fort që në analizën për natyrën e pavlefshmërisë së fletëve të votimit, grupet e punës duhet të kenë në konsideratë praktikën e vendosur nga KAS dhe Kolegji Zgjedhor në vendimmarrjen e tyre, në rastet e rinumërimit gjatë procesit të ankimimeve.

Gjykohet se është me shumë vlerë që të maksimizohet vlera e këtij procesi, duke shkuar përtej e vendosur një praktikë të konsiderimit të rasteve të fletës së votimit të pavlefshme, praktikë e cila mund të shërbejë më pas edhe për trajnimin e administratës zgjedhore për këtë çështje, si dhe zhvillimin e saj drejt një praktike të unifikuar më pas.

Duke qenë se ka një sërë tipologjish të rasteve dhe secila prej tyre implikon një sërë diskutimesh nga ato objektive deri edhe me esenciale e parimore kushtetuese, është e nevojshme që ky diskutim i kryer dhe ezauruar nga palët në organet e drejtësisë zgjedhore, veçanërisht nga Kolegji Zgjedhor, dhe vendimi i marrë të krijojë tashmë një standard të unifikuar vlerësimi të (pa) vlefshmërisë ose jo së votës.

## **9. Lidhur me saktësinë e pyetjeve të paraqitur në formularët e përgatitur**

Konstatohet se një pjesë e konsiderueshme e pyetjeve të procesverbalit janë problematike, pasi brenda një pyetjeje të vetme përfshihen disa të tilla.

Në këto raste, qarkimi i alternativës “po” ose “jo”, nuk e bën të qartë nëse fenomeni nuk është verifikuar, apo nuk është plotësuar kushti paraprak, ç’ka i bën të dhënat e evidentuara në këtë formular jo të besueshme, deri totalisht të pavlefshme për një analizë të mëpasshme.

### **Konkretisht:**

#### **Pyetja 1.6:**

“A ka kopje të PV të hapjes dhe të mbylljes në kutinë e Votimit për Këshill”.

Përgjigjja për këtë pyetje është e mbyllur në “po” ose “jo”. Ndërkohë pyetja e ndërtuar përmban dy pyetjet brenda, si për procesverbalin e hapjes edhe për atë të mbylljes.

Në rast se gjendet njeri dhe jo tjetri, përgjigjja ngelet në të dyja alternativat e pa plotë, jo tërësisht e saktë, dhe për rrjedhim edhe informacioni i marrë prej saj i tillë.

#### **Pyetja 2.1:**

“A është zarfi i vërtetimeve PEI në kutinë e materialeve zgjedhore”.

Përgjigjja për këtë pyetje është e mbyllur në “po” ose “jo”. Nëse përgjigjja është jo, a nënkupton kjo që zarfi i vërtetimeve PEI nuk është fare apo nuk është në kutinë e materialeve zgjedhore?

Në këtë rast për të patur një informacion të sakte dhe të pa interpretueshëm do duhet që pyetja 2.1 të paraprihet nga pyetja “A është zarfi i vërtetimeve PEI të QV-së”, dhe më pas “Nëse po, ku ishte vendosur ai” apo “Nëse po, a ishte vendosur ai .... vijon emërtimi i çdo kutie ku zarfi mund të jetë vendosur”.

#### **Address:**

Rr. "Ymer Kurti",  
Nd.4, H.2, Ap.3,  
Nj.Adm.5,  
Tirana

#### **Mailing address:**

P.O.Box. 2396  
Tirana, 1001,  
Albania

**Pyetja 2.2:**

“A është raporti i mbylljes PEI ne kutinë e MV?”

Edhe kjo pyetje duhet t’i nënshtrohet të njëjtin formatim sikurse pyetja 2.1, në mënyrë që të merret përgjigje e plotë dhe tërësisht e saktë.

**Pyetja 2.3, gërma c:**

“Zarfi “VËRTETIME TË IDENTIFIKIMIT ELEKTRONIK TË ZGJEDHËSVE””

Gjykohet se është e përsëritje e pyetjes 2.1.

**Pyetja 2.3, gërma d:**

“Origjinalet e vendimeve të KQV-së dhe formularët tip të vendimeve të KQV-së”.

Përgjigjja për këtë pyetje është e mbyllur në “po” ose “jo”. Ndërkohë pyetja e ndërtuar përmban dy pyetjet brenda, duke kërkuar informacion për origjinalet e vendimeve të KQV-së, si dhe formularët tip të vendimeve të KQV-së.

Në rast se gjendet njeri dhe jo tjetri, përgjigjja ngelet në të dyja alternativat e pa plotë, jo tërësisht e saktë, dhe për rrjedhim edhe informacioni i marrë prej saj i tillë.

**Pyetja 2.3, gërma h:**

“PV për mbylljen e QV një ditë para ditës se zgjedhjeve dhe marrjen në dorëzim?”

Kjo pyetje konsiderohet se është e njëjtë me pikën e fundit të **pyetjes 2.4 “KQZ-00-11 dhe KQZ-0014** (PV për mbylljen e QV një ditë para ditës se zgjedhjeve dhe marrjen në dorëzim të QV-së)?”.

Përpos se pyetja duhet vendosur vetëm një herë, ajo duhet të ndahet në dy pjesë, duke qenë se përmban dy pyetje në vetvete.

Njëra pyetje lidhet me projektvendimin për mbylljen e QV-së një ditë para ditës së zgjedhjeve, ndërsa tjetra me marrjen në dorëzim të QV-së.

Pavarësisht se modelet e formularëve KQZ-00-11 dhe KQZ-0014 janë të Lidhur me njëri-tjetrin ata ngelen dy formularë të ndryshëm, për të cilët kontrolli dhe përgjigjja duhet të jetë e veçuar.

**Pyetja 3.1 gërma a:**

“KQV-ja ka marrë merr vendim për: a) hapjen e votimit në ora 07:00?”

Përgjigjja për këtë pyetje është e mbyllur në “po” ose “jo”. Nëse përgjigjja është jo, a nënkupton kjo që KQV-ja nuk ka marrë fare vendim për hapjen e votimit apo që KQV-ja nuk e ka marrë këtë vendim në orën 7.00 por në një orë tjetër?

Për të evituar paqartësitë në përgjigjen e vendosur, pyetja duhet të limitohet fillimisht tek marrja ose jo e vendimit dhe më pas të pasohet nga alternativa apo pyetje të tjera të cilat përcaktojnë orarin e marrjes së vendimit.

**Address:**

Rr. "Ymer Kurti",  
Nd.4, H.2, Ap.3,  
Nj.Adm.5,  
Tirana

**Mailing address:**

P.O.Box. 2396  
Tirana, 1001,  
Albania

**Pyetja 3.1 gërma e:**

“KQV-ja ka marrë merr vendim për: e) mbylljen e votimit në ora 19:00?”.

Është i njëjti arsyetim si në rastin e pyetjes 3.1. gërma a.

**Pyetja 3.4:**

“Raporti i hapjes së procesit të identifikimit elektronik ndodhet në KMV të nënshkruar nga anëtarët e KQV-së, vulosur nga Sekretari i KQV-së me vulën e KQV-së?”

Pjesa e parë e pyetjes gjykohet se duhet vendosur në seksionin “II. Kutia e materialeve Zgjedhore”, së paku pjesa që konsiston në gjetjen ose fizike të raportit.

Ndërsa pjesa tjetër e pyetjes që ka të bëjë me plotësimin e detyrave nga anëtarët e KQV, mund të qendrojë tek seksioni “III. Kërkesat ligjore të KQV-së”.

Përpos kësaj, pyetja përmban disa elemente të ndryshëm të procesit të cilat duhet të jenë pyetjet më vete dhe jo të përmbledhur në një pyetje me përgjigje të mbyllur.

Konkretisht ajo duhet të konsistojë në gjetjen ose jo të raportit të hapjes së procesit të identifikimit elektronik, më pas në pyetjet e veçanta se në cilën kuti u gjet ky raport, dhe më pas sërish në pyetjet të tjera të veçuara:

Së pari “A ishte nënshkruar nga anëtarët e KQV-së?”, pyetjet për të cilën alternativat e përgjigjes duhet të jenë tre, po, jo dhe pjesërisht.

Më pas “Nëse pjesërisht, sa prej anëtarëve kanë firmosur?”.

Së dyti, “A ishte vulosur nga Sekretari i KQV-së me vulën e KQV-së?”.

**Pyetja 3.6:**

“Ne rast se PEI nuk është riparuar apo nuk është zëvendësuar, pas kalimit të tre orëve nga koha e njoftimit të qendrës së asistencës teknike, KQV ka marrë vendim për të vijuar votimin pa PEI?”

Për këtë pyetje, përgjigja është “po” ose “jo”. Kjo pyetje nuk lejon të gjykohet se në sa prej qendrave të votimit për të cilat përgjigja është “Jo” nuk ka patur probleme me PEI dhe, si rrjedhim, nuk është njoftuar KZAZ-ja dhe nuk ka patur nevojë të merret vendim për vazhdimin e votimit pa përdorimin e PEI-t, apo ka patur problem PEI dhe nuk është marrë vendim për vazhdimin e votimi manualisht.

Kjo pyetje, e ndërtuar në këtë mënyrë, dhe me kufizim përgjigjesh “po” ose “jo”, e bën të pamundur të gjykohet nëse ka patur raste të tilla dhe, nëse po, sa janë ato.

**Grup-pyetjet 3.2:**

Ky seksion konsiston në pyetje që kanë të bëjnë me Librin e Protokollit të Mbledhjeve.

Nisur nga gjetjet e auditimit paszgjedhor të vitit 2021, ku u vërejt se në një numër të konsiderueshëm të Qendrave të Votimit, LPM nuk ishte fare në kutinë e materialeve zgjedhore, konsiderohet e arsyeshme që i gjithë seksioni të fillojë me pyetjen, “A është LPM në kutinë e materialeve zgjedhore”, “A është plotësuar LPM?”, dhe më pas të vijojnë pyetjet që konsistojnë në plotësimin e tij.

**Address:**

Rr. "Ymer Kurti",  
Nd.4, H.2, Ap.3,  
Nj.Adm.5,  
Tirana

**Mailing address:**

P.O.Box. 2396  
Tirana, 1001,  
Albania



### **Pvetjet 3.3, 3.5, 3.6, 3.7, 3.8:**

Këto pyetje lidhen me procesin e Identifikimit Elektronik të Zgjedhësve.

Gjykohet se ato duhet të riorganizohen në një seksion më vete të veçantë, i cili duhet të përmbajë pyetje të shkurtra mbi çdo specifikë të PEI, në mënyrë që informacioni i mbledhur të shërbejë për kontrollin e punës së operatorëve në funksion të përmirësimit të saj në të ardhmen.

Duke ju falënderuar edhe njëherë për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin në vazhdimësi,

**Me konsideratë,**

***Për* Koalicionin Për Reforma, Integrim  
dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK)**

**Premto GOGO**

**Kryetar**

**Address:**

Rr. "Ymer Kurti",  
Nd.4, H.2, Ap.3,  
Nj.Adm.5,  
Tirana

**Mailing address:**

P.O.Box. 2396  
Tirana, 1001,  
Albania